



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ENKELEIDA I. HOXHA  
ADRESA Lagjia NR.5, Rr.  
BLV"BAJRAM CURRI", GODINA I  
MAJI, AP. NR.22, HYRJA 3  
TEL: 0682035826

# VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 1500

Tirane më 31/05/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053570104135459

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ENKELEIDA I. HOXHA



V2023053570104135459

DATE 31/05/2023  
NR REP 1500

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot para meje Notere **ENKELEIDA I. HOXHA**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tirane, me zyrë në adresën Tirane, Lagjia NR.5, Rr. Blv."Bajram Curri", Godina 1 Maji, Ap. Nr.22, Hyrja 3, u paraqiten personalisht:

**Arbi Çelepija**, atësia Fatmir, amësia Eli, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Dritan Hoxha; Nd. 149; H. 16; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 21/07/1987, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033240215 dhe nr. personal I70721072W.

**Granit Neziri**, shtetas Kosovar, lindur në Bellopoje, lindur më 11/08/1992, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID me nr. 217329.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **Delivery Pizza** sh.p.k., bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



ENKELEIDA I. HOXHA



***I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DELIVERY PIZZA" SH.P.K***

***KAPITULLI I***

***DISPOZITA TE PERGJITHESHME***

***NENI 1***

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar eshte emeruar "DELIVERY PIZZA" SH.P.K. e qe ketu e ne vazhdim do te quhet Shoqeria. Shoqeria do te jete person juridik Shqiptar sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Shoqeria do te gezoje te gjitha te drejtat si person juridik dhe do te filloje veprimtarine e saj nga data e regjistrimit ne organet kompetente.

***NENI 2***

Shoqeria eshte krijuar dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te legjislacionit Shqiptar perkates ekzistues, apo ne perputhje me Statutin dhe kontraten per themelimin e Shoqerise ashtu edhe dokumentet e tjera te rena dakort nga palet.

***NENI 3***

Shoqeria do te kete Seline e saj ne adresen: Rruga Konferenca e Pezes, Nd. 136, Ap. 2, Zone Kadastrale 8210, me Nr. Pasurie 5/128+1-N2, Kod Unik 8210006026, Tirane.

Shoqeria do te kete te drejte te lidhe kontrata, te perfitoje te drejta pasurore dhe te drejta personale jo pasurore, te mare persiper detyrime, te veproje si padites ose i paditur ne Gjykate. Shoqeria do te kete vulen e saj modeli i se ciles miratohet nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve.

***NENI 4***

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 15 vjet nga data fillimit dhe mund te zgjatet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Shoqeria mund te shperbehet perpara ketij afati nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve sic eshte percaktuar ne statut.



## NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

“Realizimi dhe menaxhimi i aktivitet te shperndarjes se ushqimeve dhe pijeve, ne bare, fast food, piceri, self service, rosticeri, gastronomi, lokale nate, restorante perfshire argetimin dhe spektaklin; realizimin dhe menaxhimin per llogari te vetem apo per te trete, te hotelerise ne struktura turistike si fshatrat turistike, pensione dhe hotele, ne qendra sportive te cdo tipi, ne salla kongresi dhe mbledhjesh, ne qendra krijimi, te kohes se lire, mensa shkollë etj.; realizimi dhe menaxhimi i aktivitetit te prodhimit dhe te tregtimit me shumice dhe pakice te ushqimeve te fresketa, konservave te ngrira, qumeshtit dhe nenprodukteve te tij, te embelsirave, produktet e brumit, produkte te vendit dhe te huaja, frutave, perimeve, vajrave, gatime te gatshme dhe sherbim catering. Te marr pjese ne shoqeri te tjera, ndermarrje dhe institucione tregtare qe kane nje objekt te ngjashem apo plotesues me shoqerine tone; te japi garanci, mbeshtetje dhe garanci te tjera personale apo reale ne favor te te treteve, perfshire Bankat dhe Institutet financiare.

Blerje te lendes se pare me qellim prodhimin e produkteve gjysem te gatshme. Veprimtari perpunim i lendes se pare dhe prodhim i produkteve gjysem te gatshme. Magazinim dhe ruajtje te lendes se pare dhe produkteve gjysem te gatshme. Shitje e produkteve gjysem te gatshme tek te gjithë kompanite e rrjetit ne Shqiperi ose jashte shtetit Shqiptar si dhe te gjithë kompanite e themeluara me qellim ushtrimin e veprimtarise fast food. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka te beje me objektivat e renditura sa me lart. Per te arritur qellimet e mesiperme, shoqeria mund te ndermarre aktivitet tregtar, financiar, qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet dhe permbushet objekti i Shoqerise. Shoqeria mund te ndermarre pjesemarrjen ne ndermarrje qe kane objekt te perafert ose te lidhur me te sajin qe funksionojne si ne Shoqeri dhe jashte. Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi sherbimi e tregtimi duke bashkepunuar me persona fizik e juridike vendas dhe te huaj, do te hape perfaqesi te kompanive te huaja, do te kryeje ndermjetesime te ndyshme, konsultime”.

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi sherbimi e tregtimi duke bashkepunuar me persona fizik e juridike vendas dhe te huaj, do te hape perfaqesi te kompanive te huaja, do te kryeje ndermjetesime te ndyshme , konsultime,

Objekti i shoqerise mund te ndryshohet ose te zgjerohet me vendim te asamblese se ortakeve.

Per te gjithë aktivitetet per ushtrimin e te cilave kerkohet licencë e posacme , shoqeria do te ushtroje aktivitetin pasi te jete pajisur me licensen perkatese nga organet kompetente.



## KAPITULI II

### TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

#### NENI 6

Cdo ortakë ka të drejtat kryesore të mëposhtme:

- Shoqëria do të administrohet në përputhje me Kontraten dhe Statutin e Shoqërisë dhe me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Ortakët do të marrin pjesë në fitimet e Shoqërisë në çdo formë e vlerë në përputhje me investimin e tyre në kapitalin e shoqërisë.
- Mbajtja e sakte e kontabilitetit dhe procedurave të mbajtjes në rregull të regjistrimeve do të vendosen, mbahen dhe ndiqen nga Shoqëria të cilat do të pasqyrojnë situatën e vertetë ekonomike e financiare, në përputhje me ligjin. Ortakëve do t'u lejohet venia në dispozicion në çdo kohë të regjistrimeve dhe të të dhënave si dhe të gjithë dokumente të tjera të rëndësishme, regjistrimet dhe llogaritë kontabile të shoqërisë sipas procedurave që rrjedhin nga Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Kontabiliteti do të mbahet në Leke. Çdo këmbim i valutes së huaj në Leke dhe anasjelltas do të realizohet sipas një kursi zyrtar të një banke në Shqipëri në datën e kryerjes së veprimit, levizja e burimeve në valute do të reflektohet në regjistrimin e operacioneve.
- Çdo ortakë mund të tërhiqet nga Shoqëria nëse veprimi është në përputhje me nenin 8 të këtij statuti.

#### NENI 7

Cdo ortakë do të ketë këto detyrime kryesore.

- Të sigurojë të dhënat e nevojshme brenda kontrollit të vecantë për Shoqërinë për zhvillimin e planeve të punës dhe për mbarevajtjen e operacioneve të Shoqërisë.
- Të kryejë detyrat e tjera të caktuara nga statuti për realizimin e qëllimit dhe objektivave të Shoqërisë.

#### NENI 8

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pjesët e kapitalit themeltar mund të kalojnë personave të tretë jashtë shoqërisë, pasi është aprovuar me



unanimitet nga ortaket. Ortaket kanë te drejten e parablerjes se pjeseve te kapitalit themeltar, ndaj njeri tjetrit. Te gjithë ortaket duhet te informohen per planin e transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar.

Nese Shoqeria nuk njofton vendimin e saj brenda dy muajve nga data e marjes se informacionit, transferimi quhet i aprovuar, nese Shoqeria refuzon aprovimin e transferimit, brenda dy muajve nga ky refuzim ortaket duhet ta blejne vete ose tu lejojne paleve te treta te blejne pjesen e kapitalit themeltar sipas rregullave te percaktuar ne Ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

#### **NENI 9**

Veprimaria e Shoqerise do te bazohet ne te ardhurat ekonomike (nxjerja e fitimeve) te ortakeve, dhe reflektohet ne deklaratat e humbjeve dhe fitimeve (bilanceve).

Shoqeria do te administroje vete pasurite e veta dhe do te kete te drejten e perdorimit dhe posedimit te ketyre pasurive ne perputhje me qellimet dhe objektivat e Shoqerise.

### **KAPITULLI III**

#### **KUSHTET EKONOMIKE**

#### **NENI 10**

Kapitali themeltar do te vendoset ne Shoqeri nepermjet kontributeve te ortakeve. Vlera e kapitalit themeltar eshte 1000 (nje mije) Leke ose 2 (dy) kuota dhe e ndare si vijon:

**1. Z. Granit Neziri**, zoteron 1 (nje) kuote ne vlere te pergjithshme 510 (peseqind e dhjete) Leke, qe perfaqesojne 51 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise.

**2. Z. Arbi Çelepija**, zoteron 1 (nje) kuote ne vlere te pergjithshme 490 (katerqind e nenetedhjete) Leke, qe perfaqesojne 49 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Kapitali themeltar mund te rritet nje ose disa here edhe nepermjet kontributeve ne natyre. Ne rast se kapitali i Shoqerise e tejkalon ate qe nevojitet per realizimin e objektiveve te shoqerise ai mund te reduktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Kapitali themeltar mund te shtohet dhe me kontributet shtese te paleve sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").



Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

#### **NENI 11**

Viti financiar i Shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te vitit financiar administratori nepermjet eksperteve kontabel te autorizuar nga Asambleja e Ortakeve do te pergatise bilancin vjetor dhe llogarine e humbjeve dhe fitimeve te shoqerise. Raporti vjetor financiar i paraqitet ortakeve per aprovim para 31 marsit te vitit pasardhes. Raportet tre mujore financiare do ti paraqiten Mbledhjes se Ortakeve brenda 30 diteve nga mbyllja e tre mujorit.

#### **NENI 12**

Shoqeria cakton nga fitimet e saj nje fond rezerve. Caktimi i fondit rezerve behet ne masen 5 % te fitimeve sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Pervec fondit rezerve shoqeria mund te krijojë dhe fonde te tjera per realizimin e objektive te saj me miratim te Asamblese se Ortakeve. Shoqeria paguan taksat dhe detyrimet e tjera ligjore perpara Shtetit Shqiptar. Humbjet ose fitimet e mbartura nga viti i kaluar zbriten ose shtohen respektivisht. Mbas aprovimit te llogarive vjetore dhe verifikimit te shumes se parave qe do te shperndahet, Asambleja e Ortakeve vendos pjeset qe do ti shperndahen ortakeve.

### **KAPITULI IV**

#### **NENI 13**

Organi vendimarrës i Shoqerise do te jete Asambleja e Ortakeve. Ajo perbehet nga ortaket me te drejte vote ne perpjestim me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

#### **NENI 14**

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve do te thirret si rregull nga Administratoret e Shoqerise nepermjet nje njoftimi me shkrim jo me pak se 15 dite para dates se mbledhjes. Njoftimi do te perfshije rendin e dites, vendin, daten dhe kohen e mbledhjes. Nje ose me shume ortake qe perfaqesojne mbi 5 % te pjeseve te kapitalit themeltar mund te kerkoje mbajtjen e nje mbledhje te Asamblese se Ortakeve. Ne qofte se ortaket nuk thirren sipas procedures se pershkruar me siper mbledhja eshte e vlefshme nese jane te pranishem te gjithe ortaket. Mbledhja e ortakeve do te mbidhet te pakten dy here ne vit.



Cdo ortake ka te drejte te mare pjese ne mbedhje por ai mund te perfaqesohet nepermjet nje prokure te posacme nga nje person tjeter per te cilin nuk eshte e nevojeshme te jete ortake ne Shoqeri.

#### NENI 16

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve i merr vendimet e saj ne perputhje me Ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Statutin e Shoqerise dhe kontraten e themelimit. Procesverbali i mbledhjes duhet te firmoset nga ortaket e shoqerise.

#### NENI 17

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve ka keto kompetenca:

1. Percakton objektin e veprimtarise se Shoqerise dhe mund ta ndryshoje ate.
2. Miraton politiken e zhvillimit te Shoqerise.
3. Miraton ekspertet kontabel dhe bilancin e Shoqerise.
4. Percakton masen e fitimit qe do ti shperndahet ortakeve te Shoqerise ne formen e dividendit.
5. Te emeruje likujdatoret e Shoqerise.
6. Te aprovoje shtesa te neneve te Statutit ose kontrates, duke perfshire nje rritje te kapitalit themeltar ose zvogelim te tij, ndryshime lidhur me qellimin e veprimtarise se Shoqerise.
7. Percakton procedurat e mbulimit te humbjeve.
8. Miraton rregullore te procedurave te brendeshme te punes, duke percaktuar numerin e nenpunesve ne Shoqeri.


#### NENI 18

Shoqeria do te administrohet nga Administratori i Shoqerise, i cili eshte **Z. Arbi Çelepija**. Mandati i Administratorit zgjat 5 (pese) vjet. Cdo marreveshje e shoqerise me te tretet kerkon domosdoshmerisht miratimin e Administratorit.

#### NENI 19

Administratori do te kete autoritet te pergjithshem ne aktivitetin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise dhe ka te drejten e marrjes se cdo ndermarje dhe cdo veprimi qe konsiderohet i nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise me perjashtim te rasteve qe Ligji 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe neni 17 i Statutit ia rezervon





Asamblese se Ortakeve. Administratori ka te drejte ti propozoj mbljedhjes se Asamblese se Ortakeve planin e mbledhjeve duke mare vendime per zhvillimin e veprimtarive te Shoqerise, duke percaktuar dhe linjat kryesore te veprimtarise se Shoqerise. Veprimtaria e Shoqerise do te drejtohet nga Administratori i saj.

#### **NENI 20**

Administratori ka keto kompetenca:

- a. Te drejtoje veprimtarine e perditeshme te Shoqerise.
- b. Te mbikqyre zbatimin e planeve te Shoqerise dhe te raportoj per to Asamblene e Ortakeve.
- c. Te administroje pasurite e Shoqerise duke perfshire dhe mjetet financiare.
- d. Te perfaqesoj Shoqerine me te tretet ne Gjykate dhe arbitrazh, te firmose kontrata ne emer e per llogari te shoqerise me miratimin e mbledhjes se ortakeve.
- e. Te raportoje dhe te pergjigjet para Asamblese se Ortakeve per veprimtarine e shoqerise.
- f. T'i propozoje Asamblese se Ortakeve shtesa ne Statut duke perfshire nje rritje ose zvogelim te kapitalit themeltar.
- g. Marrjen e vendimeve per te gjitha ceshtjet e tjera qe lidhen me drejtimin e shoqerise brenda kompetencave te caktuara nga Asambleja e Ortakeve.
- h. Cdo tre mujor Administratori se bashku me financierin e Shoqerise do te pergatisin bilancin dhe do ja paraqesin Asamblese se Ortakeve mbi bazen e te cilit do te merren vendime perkatese.

Shoqeria nuk eshte pergjegjese per pasojat kundrejt te treteve kur mund te provoje se pala e trete ishte ne dijeni se Administratori ka tejkaluuar qellimet e Shoqerise ose kur palet e treta nuk mund te mos ishin ne dijeni te ketyre veprimeve ne rrethana te caktuara.

#### **KAPITULLI V**

#### **PUSHIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 21**

Veprimtaria e Shoqerise do te pushoje brenda afatit te kohezgjatjes se veprimatarise se Shoqerise.

#### **NENI 22**

Shoqeria likujdohet sipas procedurave te meposhtme ne perputhje me Ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".





Asambleja e Ortakeve do te emeroje komisionin e likujdimit i cili do te dorezoje per aprovim bilancin perfundimtar te likujdimit dhe dokumentet e lidhura me te sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe Asamblese se Ortakeve, shoqeria pushon veprimtarine e saj si dhe mbyllja e shoqerise do te regjistrohet ne regjistrin tregtar. Mbledhja e ortakeve vendos unanimitisht qe mjetet e sjella nga njeri prej ortakeve do ti kthehen atij duke e kredituar per vleren dhe koston e kthimit ne vendin e ortakut. Ne qofte se Asambleja e Ortakeve vendos unanimitisht te paguaje borxhet nese ka, qe rezultojne nga bilanci perfundimtar, do te perpiqet t'ia shese mjetet dhe pasurite nje personi te trete me cmime dhe kushte te favorshme duke mare parasysh dhe amortizimin fiktiv.

#### **NENI 23**

Per konfliktet qe mund te lindin brenda Shoqerise organi kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### **NENI 24**

Ceshtjet e pa mbuluara nga ky Statut do te regullohen nga legjislacioni Shqiptar dhe ne vecanti nga Ligji 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

### **ORTAKET E SHOQERISE**

**GRANIT NEZIRI**

**ARBI ÇELEPIJA**